

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QARKU BERAT

BASHKIA BERAT

Njësia Administrative Sinjë

PROJEKT PER RIPARIM LERE ME PLASMAS

Fshati: Sheshi Vrekaj

Emri popullor i vendit:

Ekonomia Pyjore: Mali i Molishtit

Ngastra: 88

PROJEKTOI

ING: NDERIM QATO

ING: ALDO FILAJ

ING: REDI MET'HOXHA

KONTROLLOI

PERGJEGJES SEKTORI

JURGEN ABEDINI

MIRATOHET

DREJTORI

BLEDAR ÇILI

VITI 2026

KAPITULLI I

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

- **Përmbledhje e projektit:**

Riparim i lerës së betonit në Ekonominë pyjore Mali i Molishtit .

- **Qëllimi;**

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 22.datë 27.02.2026 për miratimin e buxhetit për vitin 2026. Riparimi i lerës me plasmas në ngastrën 88 të Ekonomisë Pyjore Mali i Molishtit. Kjo ka për qëllim të ndikojë drejtpërsëdrejti të zgjidhja e problemit për ujin e tufave të bagëtive që mbarështohen nga blegtorët e Fshatrave Molisht, dhe Leshnje në NJ.A Sinjë, si dhe gjithë zonës për’rreth, pasi kjo lerë është tejet e amortizuar dhe jashtë funksionit.

- **Objektivat Projektit:**

Riparimi i lerës me plasmas në këtë sipërfaqe kullosore ka për objektiv , sigurimin e ujit kryesisht për bagëtitë si dhe për faunen e egër , pasi në këto sipërfaqe haset lepuri i egër , dhelpra, ujku, si dhe shpend si mellenja , thelleza etj.

Plani i Punës përshkruhet në formë tabelare.

Plani i Punës	Menaxhimi i Projektit	Afati
Objekti	Riparimi i lerës me plasmas	
Lider i PP.	D.B.AP, U SHV , Bashkia Berat	
Detyrat	.Pastrimi i bimëve dhe shkurreve brenda perimetrit të lerës.	1 ditë
	. Heqja e gurëve të kalldrëmit, dhe nxierja jashtë perimetrit rrethues.	15 ditë
	.Shoshje dheu	20 ditë
	Shtrimi i shtresës së parë të plasmasit.	3 ditë
	Transport materiale ndertimi si rere dhe çimento	2 ditë
	. Mbushja me dhe 20 cm mbi shtresën e parë të pasmasit dhe ngjeshja me tokmak	16 ditë
	.Shtrimi i shtresës së dytë të pasmasit	3 ditë
	.Mbulimi me dhe 20cm i shtrsës së dytë të plasmasit dhe ngjeshja me tokmak	16 ditë
	.Shtrimi i kalldrëmit ne brëndësi të lerës	14 ditë
	Rregullimi i mureve rrethuese si dhe hedhja e shtresës me beton.	10 ditë

KAPITULLI II

TË DHËNAT E OBJEKTIT

- **Vendosja gjeografike dhe administrative:**

Përshkruaj pozicionin gjeografik të objektit):

Objekti: lërë për pirjen e ujit të bagëtive në vëndin e quajtur lera Veleshnje ,bën pjesë në ekonominë pyjore/kullos/ Mali i Molishtit parcela/nënparcela 88 , në Nj. Admin. Sinjë, Bashkia Berat,

- **Kufijtë Natyralë:**

Objekti lera uji ,për pirjen e ujit nga bagëtitë në vëndin e quajtur lera e Veleshnjes

Nga veriu, kufizohet me parcelen nr-6

Nga jugu, kufizohet me parcelen 87

Nga lindja kufizohet me parcelen 89

Nga perëndimi kufizohet me parcelen 90

- **Sipërfaqja:**

Parcela/at/nënparcela/at nr.88 Ekonomia pyjor/kullosore. Mali i Molishtit ka një sipërfaqe prej 90.46 ha, e cila shfrytëzohet për kullotje gjatë gjithë vitit nga fermerët e zonës

- **Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara:**

Largësia nga qendra e banuar e fshatit Cukë është 1 km,

Distanca nga objekti lera e Veleshjes me qendrën e Njësia Administrative. Sinjë është 5 km . nga qendra e Bashkisë Berat , 22 km,

- **Gjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia:**

Forma e rielievit , rrafshnaltë me pjerrësi 20 - 35 %, shkëmbi amnor gëlqeror .

- **Kundrejtimi:**

Objekti Lera me plasmas ka kundrejtim jug-lindje

- **Lartësia:**

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e parcelës është 620 m, lartësia minimale 430 m, lartësia maksimale 740 m.

- **Rrjeti hidrografik:**

Objekti është i varfër me burime ujore. E vetmja mundësi për të siguruar uji për bagëtitë si dhe për faunën e egër është vënia në funksjon i kësaj lere me plasmas pasi nuk ka asnjë burim tjetër hidrik.

- **Përbërja e bimësisë:**

Kjo kullotë ka përbërje të llojit dëllinjë, bezgë të egër. dhe bulgër ,

Shtresa barishtore përbëhet kryesisht nga llojet graminore si dhe në një përqindje të moderuar edhe nga bimësi leguminoze

- **Kushtet klimatike:**

Ekonomia pyjore e marrë në studim përfshihet ndermjetnë zonave klimatike mesdhetare kodrinore të Shqipërisë dhe zones klimatike klimatike mesdhetare kodrinore -malore(nenzona qendrore)

- . Klima e kësaj zone karakterizohet nga dimra të butë e të lagët dhe vera të nxehta e të thata. Sasia minimale e rreshjeve është ne periudhen e verës, gjatë muajve korrik dhe gusht, rreth 60-70 mm dhe maksimalja gjatë periudhës së dimrit, rreth 1.200 mm..
- Temperatura mesatare vjetore 15.9°C , me temperaturë absolute më të ulët -12.2°C dhe temperaturë absolute më të lartë 44.5°C
- Nga të dhënat statistikore rezulton se temperatura mesatare shumevjeçare minimale është rreth 5°C , në muajin janar, ndërsa temperatura mesatare shumevjeçare maksimale është rreth 22°C , në muajin korrik. Temperatura mesatare vjetore është rreth 14°C

- Diellzimi Një nga elementet bazë që karakterizon klimën e një zone është regjimi i diellzimit, i shprehur me anë të numrit të ditëve të kthjellta e të vranëta. Për zonën në studim, numri i ditëve të kthjellta luhet nga 6÷7 dite në muajt e dimrit deri në 16÷19 dite në muajt e verës. Mesatarisht gjatë vitit vërohet rreth 1÷2 dite të vranëta në periudhën e verës dhe 10÷12 dite të tilla gjatë e dimrit.

Shifrat tregojnë një potencial të konsiderueshëm të energjisë diellore për zonën në studim, element ky shumë i favorshëm për zhvillimin ekonomik të zonës.

Temperatura e ajrit një element shumë i rëndësishëm në karakterizimin e klimës së një zone të caktuar është regjimi i temperaturave.

- Temperatura mesatare vjetore luhet nga 15 deri 16 C. Janari është muaji më i ftohtë i vitit. Ai karakterizohet nga luhetje të temperaturës $-0^{\circ}\text{C} \div 20^{\circ}\text{C}$. Gjatë muajit më të ngrohtë, korriku, temperatura mesatare luhet nga $19 \div 34^{\circ}\text{C}$.

Reshjet

- Reshjet arrijnë në 1250 mm në vit. Këto vlera janë relativisht jo të larta krahasuar me mesataren vjetore në rang vendi që është rreth 1450 mm. Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë periudhës së ftohtë të vitit, duke arritur kulmin në muajin nëntor me 13-14 % të reshjeve vjetore, ndërsa muaji më i thatë i vitit është korriku me 3 % të reshjeve vjetore.
- Era ; kurora e formuar nga kodrat që kufizojnë hapsirën bën që drejtimet mbizotëruese të erës jone verilindja dhe juglindja. Për të njëjtat arsye, shpejtësitë mesatare të erës janë me të vogla nga drejtimet perëndimit

- **Tokat:**

Nga te dhenat pershkrimeve parcelare rezulton se siperfaqet pyjore shtrihet mbi kryesisht mbi formacione gelqerore

- **Nevojat për ujë të pijshëm për blegtorinë:**

Në kete sipërfaqe kullosore aktualisht kullosin rreth 520 krerë bagëti të imta ,35 gjeth , lopë dhe viça dhe rreth 20 një thundrak. Nevojat për uji për këto bagëti është rreth 2500-3000 litra uji në ditë ne harkun e tre muajve sasia që nevoitet për plotësimin e këtyre nevojave është rreth 250000 litra uji , perafersisht 250 m^3 .


Transport I materialeve si plasmas, rërë+_cimento me kafshë pasi tereni eshte I veshtire per te kaluar me mjete transporti

Profili i lerës


PRERJA A – A

SKICA E LERES ME PLASMAS


Prerje terthore



Prerja A - A



Pamje nga sipër



20

$D =$ m : $d =$ m : $H =$ m :

PREVENTIV PËR RIPARIM LERE PLASMAS

Emri i objektit: sheshi Vrekaj, Veleshnje

Ekonomia Pyjore/Kullosore: Mali i Molishtit

Nr.i parcelës/nënparcelës: 88

Sipërfaqja: 90.46 ha

Kapaciteti 229 m³ .

Indeksi I Normes	Pershkrimi I procesit te punes	Njesia Matjes	Volumi	Ditë pune
	Pastrim i shkurreve dhe barerave	m ²	254.5	
	Heqja e gurëve të kalldrëmit, dhe nxierja jashtë perimetrit rrethues.	m ³	50	
	shtrim plasmasi me dy shtresa	m ²	550	
	Shoshje dheu per shtrim mbi plasmas .	m ³	50	
	Hedhje,ngjeshje dheu mbi plasmas me tokmak trashesi 20 cm.	m ³	50	
	Shtrim kalldremi ne trashesi 20 cm.	m ²	50	
	Ndertim mur guri te thate per mbrojtjen e leres .	m ³	8	
	Pergatitje betoni dhe berje brezi mbi mur .	m ³	1.7	
	SHUMA I			
	Blerje materiale (Plasmas per shtrim			
	Transport I matërgjaleve si plasmas, rërë+_cimento me kafshë	m ² km	600 1.5	
	SHUMA II			
	Shuma pa TVSH			
	TVSH			
	TOTALI			